

Marrëdhëniet Transatlantike dhe Ballkani Perëndimor

Hyrje

Qasja e politikës së jashtme njaft të pazakontë e administratës Trump ka çuar në një numër konfrontimesh diplomatike me BE-në dhe me disa prej anëtarëve të saj. Këto konfrontime janë reflektuar edhe në Ballkanin Perëndimor, ku SHBA-të dhe BE-ja po udhëheqin negociatat të ndara midis Kosovës dhe Serbisë. Të pakët ishin atë që kanë pritur që administrata Trump të shfaqte interesim në Ballkanin e vogël Perëndimor, por ishte pikërisht ky rajon pika ku përplasjet diplomatike mes SHBA-ve dhe BE-së ishin të dukshme. I dërguari i Trump për Dialogun Kosovë-Serbi, Richard Grenell po udhëheq këtë kauzë. Ndërsa SHBA-të ishin të hapura për të konsideruar një marrëveshje ‘tokë për paqe’, Gjermania e kundërshtoi kategorikisht këtë ide.

Grenell është i pamëshirshëm ndaj kundërshtarëve të tij. Ndërsa presidenti serb Aleksandar Vuçiç arriti të ndiqte një qasje të ekuilibruar duke mbajtur të kënaqur edhe Grenell edhe homologët e tij evropianë, ish-Kryeministri i Kosovës Albin Kurti ishte më pak i suksesshëm. Kurti gjeti pajtueshmëri me evropianët, por jo me Grenell. Të inkurajuar nga Grenell, Lidhja Demokratike e Kosovës, partneri qeverisës i Kurtit, në bashkëpunim me Presidentin Hashim Thaçi rrëzoi qeverinë e Kurtit që kishte qenë në pushtet për më pak se dy muaj. Politikanët e Kosovës mësuan se t’i mos bindeshin Grenell sjell pasoja të dhimbshme. Më pas, Grenell bëri që liderët e qeverisë tjetër të Kosovës dhe Vuçiç i Serbisë të nënshkruanin disa letra zotimi, të portretizuara si marrëveshje nga administrata amerikane, që përfshinin elemente duke filluar nga zbulimi i fatit të personave të zhdukur deri te zhvendosja ose krijimi i ambasadave në Jeruzalem, e deri tek deklarimi i Hezbollahut si një organizatë terroriste.

SHBA-të dhe i dërguari i posaçëm Grenell kanë kontroll të plotë mbi udhëheqjen e Kosovës, por më pak ndikim tek Vuçiç i Serbisë, i cili është një partner i ngushtë i Rusisë. Vuçiç ka gjetur një strategji të ekuilibruar që deri më tani duket se i pëlqen SHBA-ve dhe nuk shqetëson Rusinë. Vuçiç gjithashtu ka arritur të rifitojë simpatinë dhe mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare për Serbinë, e konsideruar si fajtori kryesor për luftërat Jugosllave. Kosova, në anën tjetër, nuk është më e preferuara e padiskutueshme e Perëndimit. Për dallim nga negociatat në Rambuje në 1999 dhe Vjenë në 2007 kur bashkësia ndërkombëtare mbajti anën e Kosovës hapur, ky shtet i ri tani gjithnjë e më shumë duhet të bazohet në vetvete.

Pas një pezullimi dy-vjeçar të dialogut, Beogradi dhe Prishtina u kthyen në tryezën e bisedimeve, por me pak vullnet për të gjetur një kompromis mbi statusin. Zyrtarët serbë refuzojnë të marrin në konsideratë njohjen e Kosovës pa marrë “diçka si kompensim”, duke aluduar në pjesën veriore të Kosovës me shumicë serbe, rreth 12 përqind e territorit të Kosovës. Një zgjidhje e shkëmbimit të territoreve doli të ishte e popullarizuar në disa vende të Evropës, por Gjermania, për të cilën shumë besojnë se e ndaloi këtë marrëveshjen e vetme, duket e vendosur për të ruajtur kufijtë ekzistues në Ballkanin Perëndimor. Kosova refuzon zgjidhjen ‘tokë për paqe’, por gjithashtu heziton të ofrojë

ndonjë gjë në këmbim të njohjes. Ajo madje kundërshton formimin e një Asociacioni tashmë të dakorduar të Komunave me shumicë Serbe.

Të vetëdijshëm për këto qëllime të papajtueshme të Serbisë dhe Kosovës, si SHBA-të ashtu edhe BE-ja po adresojnë çështje më periferike—projekte të infrastrukturës, njohje të diplomave, personat e zhdukur—ndërsa vendosin statusin në sirtar për momentin. Megjithëse proceset nuk janë aq të qarta, Grenell pretendon të merret me çështje ekonomike, ndërsa BE-ja me ato politike. Grenell është tërhequr kohët e fundit, duke ndryshuar pozicionin e tij të mëparshëm të ‘të shkuarit vetëm’, duke premtuar që SHBA-të do të bashkëpunojnë me BE-në. Mathew Palmer, i dërguari i Departamentit të Shtetit të SHBA-ve për Ballkanin, është parë në takimet me zyrtarët e BE-së në Bruksel.

Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse (CIG) dhe Fondi Vëllezërit Rockefeller (RBF) organizuan në 16 shtator 2020 telekonferencën e parë për një numër ish-diplomatësh të SHBA-ve dhe BE-së për të diskutuar përpjekjet paralele SHBA-BE në mosmarrëveshjen Kosovë-Serbi, me ç’rast ofruan rekomandimet e tyre për një iniciativë dhe vizion të unifikuar për t’i dhënë fund konfliktit. Ky projekt i CIG-së mbështetet nga RBF. RBF dhe CIG planifikojnë të vazhdojnë diskutimin gjatë vitit 2020 dhe 2021.

Ky raport bazohet në diskutimet e mbajtura nën Rregullen e Chatham House. Pjesëmarrësit morën pjesë në diskutime në cilësinë e tyre personale. CIG është përpjekur të jetë i saktë dhe i ekuilibruar në përmbledhjen e diskutimeve dhe kërkon mirëkuptim nga pjesëmarrësit, diskutimet e të cilëve mund të mos jenë përfshirë plotësisht në këtë raport të shkurtër. Raporti nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e CIG-së dhe RBF-së.

Një punë e papërfunduar

Dy dekada pas luftës së fundit në Ballkan, rajoni mbetet një "punë e papërfunduar". Serbia nuk e njeh Kosovën, Republika Srpska në Bosnjë dhe Hercegovinë aspiron të ndahet, anëtarësimi në BE po bëhet një realitet i largët, dhe demokracitë e porsalindura po zbrapsen. Mbështetja e rajonit në zbatimin e reformave demokratike është po aq e rëndësishme sa ndihma për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërshtetërore. Bashkëpunimi diplomatik transatlantik dhe koordinimi i "shkopinjve dhe karrotave" janë thelbësore për përfundimin e mosmarrëveshjeve të pazgjidhura dhe përgatitjen e rajonit për integrimin në BE.

SHBA-të dhe BE-ja kanë një vizion të ngjashëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së statusit Kosovë-Serbi: njohja e ndërsjellë dhe anëtarësimi në BE për Serbinë dhe Kosovën. Megjithatë, dialogu Kosovë-Serbi është bërë një çështje e mosmarrëveshjes transatlantike, me SHBA-të dhe BE-në që udhëheqin iniciativa të ndara, të pakoordinuara dhe shpesh konfliktuoze. Divergjenca duket se është shkaktuar nga ambiciet personale të zyrtarëve të Shtëpisë së Bardhë. I dërguari i Shtëpisë së Bardhë për konfliktin Kosovë-Serbi Richard Grenell, i cili ka një prirje të fortë për konflikt, po udhëheq një iniciativë të pavarur dhe mjaft konfuze. Edhe zyrtarët e Departamentit të Shtetit duket se janë jashtë rrjedhave. Disa pjesëmarrës raportuan se bashkëpunimi SHBA-BE nën Shtëpinë e Bardhë është i mirë por "jo aq me ndikim". Shumë pjesëmarrës shpjeguan se SHBA-të dhe BE-ja kanë një histori solide historike dhe një bazë të fortë të kompetencës për të punuar së bashku. Ndonëse në të kaluarën mund të mos jenë rënë dakord privatisht, asnjëra palë nuk ka fajësuar tjetrën për ndonjë gjë publikisht.

Pavarësisht nga dallimet e qëndrimeve mes SHBA-ve dhe BE-së, problemet nuk janë në Washington ose në Bruksel, por në Prishtinë dhe Beograd. Vazhdimi i status quo-së do të prekë Serbinë dhe Kosovën, e jo BE-në ose SHBA-të. Beogradi duket të ketë interes për një kompromis që i ofron Serbisë anëtarësim të shpejtë në BE, por pa trajtuar çështjet e sundimit të ligjit dhe lirisë së shtypit. Presidenti Vuçiç dëshiron të anëtarësohet në BE si autokrat, jo si demokrat. Mesazhi transatlantik për Vuçiçin duhet të jetë se ai duhet të bëjë të dyja: zgjidhjen e mosmarrëveshjes së Kosovës dhe zbatimin e reformave demokratike të nevojshme për anëtarësimin në BE. BE-ja duhet ta mirëpresë Serbinë në bashkim, por vetëm pasi Beogradi të përmbushë kriteret. "BE-ja duhet të jetë e qartë për këto kushte."

Disa folës argumentuan se agjenda e BE-së në Ballkanin Perëndimor nuk është aq ambicioze sa duhet. Dialogu një dekadësh i BE-së në ndërmjetësimin Kosovë-Serbi ka adresuar çështjet periferike të konfliktit - diplomat, dokumentet - por ka neglizhuar thelbin e konfliktit - statusin. Nisma e SHBA-ve poashtu promovon bashkëpunimin ekonomik dhe inkurajon zgjidhjen e disa problemeve praktike brenda një zgjidhjeje "afatgjatë", poashtu duke neglizhuar statusin. Duket se Beogradi dhe Prishtina favorizojnë këtë qasje "afatgjatë", duke u fokusuar në problemet praktike. Ndërsa udhëheqja serbe është edhe më e fortë pas një fitoreje të madhe zgjedhore, ajo nuk është ende gati për një kompromis të madh me Kosovën. Nga ana tjetër, qeveria e Kosovës është e dobët dhe nuk është në gjendje të bëjë dhe zbatojë marrëveshje gjithëpërfshirëse që përfshijnë kompromise mbi "integritetin e saj territorial ose institucional".

Beogradi duket më i aftë, por jo domosdoshmërisht më i përgatitur se Prishtina për të bërë një kompromis. Nuk është e qartë nëse Serbia mund të kompensohet për një kompromis me Kosovën. Nëse Beogradi nuk vlerëson mbështetjen e BE-së për reformat demokratike dhe zhvillimin ekonomik, atëherë nuk është e qartë se çfarë tjetër mund të bëjë BE-ja. Paratë e gatshme janë një mundësi tjetër. Një shlyerje në formën e faljes së borxhit ose një projekt i madh përveç pranimit në BE nuk duhet të përjashtohet si opsion. Paratë, megjithatë, nuk ka gjasa të zbusin pakënaqësinë e popullatës serbe, e cila kundërshton fuqimisht shtetësinë e Kosovës. Pra, një marrëveshje që përfshin edhe paratë, edhe elementet e mirëfillta të normalizimit të marrëdhënieve midis dy shoqërive është thelbësore për paqen afatgjatë midis serbëve dhe shqiptarëve.

Një punë e përfunduar është "një Ballkan Perëndimor demokratik dhe Evropian" dhe ky duhet të jetë synimi përfundimtar transatlantik.

Nuk ka normalizim pa njohje

Stabiliteti duhet të jetë një qëllim i përbashkët i SHBA-ve dhe BE-së. Mosmarrëveshja për statusin Kosovë-Serbi është një burim kryesor i paqëndrueshmërisë. Status-quo-ja është e paqëndrueshme dhe stabiliteti ekzistues është i brishtë. "Duhet vetëm një person me armë për të minuar progresin e dekadës së kaluar." Por zgjidhja e statusit duket aq e vështirë sa që të gjitha iniciativat e dialogut— procesi i Brukselit, iniciativa e Grenell—po tentojnë ta shmangin atë. Si dialogu aktual i SHBA-ve ashtu edhe ai i BE-së synojnë normalizimin, por jo njohjen reciproke. Një marrëveshje normalizimi pa njohje reciproke mund të jetë vetëm një status quo e azhurnuar. Paqja përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë mund të vijë vetëm me një marrëveshje të njohjes reciproke.

Disa folës potencuan se besojnë se Serbia mund të bëjë një marrëveshje. Por kjo kërkon një diplomaci më të fuqishme të BE-së për të rritur koston e mosbashkëpunimit. BE-ja duhet ta cekë në mënyrë eksplicite se "kompromisi me Kosovën është i pari në radhë, anëtarësimi në BE vjen i dyti". Strategjia duhet të përfshijë "më shumë shkopinje, më pak karrota". Për të rritur ndikimin e saj, BE-ja duhet të koordinojë përpjekjet e saj me pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e njohin Kosovën, për të marrë angazhimin e tyre për njohje nëse arrihet një marrëveshje, me ose pa njohje, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Njohja kolektive e BE-së për Kosovën automatikisht zvogëlon vlerën e njohjes nga Serbisë. Njohja e Serbisë është shumë larg, dhe palët e interesuara duhet ta harrojnë atë tani, dhe Kosova duhet të ndalojë "së përgjëruar Serbisë për njohje".

Krërët serbë dhe kosovarë janë ndjerë rehat me status quo-në dy dekadëshe. Shumë presin që ata t'i rezistojnë përpjekjeve ndërkombëtare që prishin këtë "paqëndrueshmëri jo të shëndetshme, por të qëndrueshme". Konflikti ndihmon elitat të zgjasin pushtetin e tyre. Kushdo që synon të prishë këtë ekuilibër nuk përfundon mirë. Kjo është një nga arsyet pse qeveria e Kurtit nuk zgjati. Qëllimi i tij për të thyer status quo-në mobilizoi si partnerët e tij qeverisës ashtu edhe udhëheqësit e opozitës për ta hequr nga pozita Kurtin. Status-quo-ja lejon udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë të konsolidojnë pushtetin politik dhe të akumulojnë pasuri për vete.

Prishtina është pjesë e zgjidhjes, por çelësi kryesor i një kompromisi është në Beograd. Presidentit Vuçiç i pëlqen të veprojë si një udhëheqës i guximshëm dhe vizionar, por ai nuk është i tillë. "Vizioni i tij fillon dhe mbaron me administrimin dhe zgjatjen e pushtetit së tij." BE-ja duhet të rregullojë alokimin e saj të shkopinjeve dhe karrotave, duke ofruar më shumë nga të parat dhe më pak nga të dytat. Në të njëjtën kohë, BE-ja dhe SHBA-të duhet të shohin se çfarë mund të bëjnë për t'i ofruar Vuçiçit një zgjidhje për kursimin nga "humbja a fytyrës", por gjithashtu ta bëjnë të qartë se çfarë mund dhe çfarë nuk mund të marrë. BE-ja duhet të jetë e qartë se nuk mund t'i ofrojë Vuçiçit ndonjë pjesë nga "toka ose uji i Kosovës".

Folësit nuk ishin optimistë se një marrëveshje gjithëpërfshirëse e normalizimit do të përfshinte njohjen nga Serbia, por mund të përfshinte njohjen e mosnjohësve të BE-së dhe anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. SHBA-të dhe BE-ja duhet të ndihmojnë më shumë Kosovën. BE-ja dhe SHBA-të po i kërkojnë Kosovës të veprojë me përgjegjësi, por thonë se nuk mund të bëhet anëtare e klubit ndërkombëtar. "Qëllimi ynë transatlantik duhet të jetë përfshirja e Kosovës në klubin tonë." Me një farë disipline dhe mbështetjeje ndërkombëtare, edhe Kosova mund të bëhet një demokraci e gjallë që mund të ketë një efekt pozitiv në demokracinë e Serbisë. "Kosova mund të jetë një shembull i demokracisë në Ballkan."

Serbia do të duhet të njohë Kosovën në këmbim të anëtarësimin në BE. "Anëtarësimi në BE nënkupton njohjen dhe Serbia e di këtë gjë." Në ndërkohë, Serbia zyrtarisht do të vazhdojë të pretendojë se Kosova është pjesë e saj përderisa negocion "problemet teknike". Megjithatë në realitet është përjashtuar dhuna si një mjet për zgjidhjen e konfliktit, asnjëra palë nuk është e gatshme të pranojë shumë. Si iniciativat e SHBA-ve, ashtu edhe ato të BE-së në fakt kanë shkëputur çështjet e Dialogut nga njohja. Shumë pjesëmarrës thanë se edhe një marrëveshje pa njohje nuk ka gjasa të ndodhë deri në fund të vitit.

Normalizimi i marrëdhënieve duket të jetë një parakusht për njohjen dhe pranimin në BE. Prandaj, strategjia për të arritur një marrëveshje përfundimtare duhet të përfshijë tre faza: normalizim, njohjen dhe anëtarësimin në BE.

Një test transatlantik

Paqja përfundimtare në Ballkanin Perëndimor mbetet një test kyç për bashkëpunim transatlantik. Ndërhyrjet ushtarake në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë, dhe negociatat pasuese të paqes ishin të gjitha përpjekje të përbashkëta të SHBA-ve dhe BE-së. Qasja e Administratës Trump shënon një largim nga ky bashkëpunim transatlantik i dëshmuar të ketë qenë i mirë, duke filluar nga Irani e deri në çështjet mjedisore në Ballkanin Perëndimor.

Mosmarrëveshja Kosovë-Serbi është e vogël dhe jo urgjente në krahasim me konfliktet e tjera globale, por është një provë themelore e bashkëpunimit SHBA-BE për zgjidhjen e konflikteve. Nëse Trump rizgjidhet, marrëdhëniet SHBA-BE do të përkeqësohen më tej dhe këto tensione do të pasqyroheshin në mënyrë të pashmangshme në Ballkanin Perëndimor, parashikuan shumë folës. Qasja e diplomacisë së Trump është "të heqë qafe njerëzit që flasin gjuhë të huaja dhe të punësoj njerëz që bëjnë marrëveshje". Me më shumë diplomaci të stilit të Trump dhe Grenell, roli dhe ndikimi i SHBA-ve do të ulet. Qasja e Trump është edhe e paekuilibruar: bëri jehonë në Beograd, por jo në Prishtinë. Lidhja e Trump me Presidentin rus Vladimir Putin është gjithashtu shqetësuese. Ai duket i fiksuar me "marrjen e lavdërimeve nga Putini" dhe nuk është sekret që Putini dëshiron të ketë kaos dhe paqëndrueshmëri në Ballkan. Një fitore eventuale e Joe Biden do të sillte një hov të ri dhe do të rivendoste bashkëpunimin e mirë transatlantik. "Fitorja e Biden do të ishte një moment i ripërcaktimit." Por palët e interesuara gjithashtu duhet të jenë të përgatitura për rizgjedhjen e Trumpit si president i SHBA-ve.

Nisma mjaft e njëanshme e Grenell për promovimin e "bashkëpunimit ekonomik" ka bërë që të dy palët të nënshkruajnë disa letra zotimesh që përfshijnë ndërtimin e një autostrade dhe një hekurudhe për të lidhur të dy vendet, për të zhvendosur ambasadat e tyre në Jeruzalem, dhe përcaktimin e Hezbollahut si një organizatë terroriste. Marrëveshja e Shtëpisë së Bardhë, siç i janë referuar letrat e zotimit, përfshin gjithashtu një numër çështjesh praktike—të tilla si njohja e diplomave, çështje që lidhen me personat e zhdukur—që janë gjithashtu në agjendën e dialogut të Brukselit. Ndërsa folësit nuk gjetën asnjë problem me listën e temave, ata ishin skeptikë rreth zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Anëtarësimi në BE dhe perspektivat ekonomike dhe politike që vijnë me të duhet të jenë një nxitje e fortë për udhëheqësit e orientuar kah interesat kombëtare, por jo për udhëheqësit autoritarë. Nuk është e qartë nëse anëtarësimi në BE është një karrotë për Serbinë. Presidenti mjaft autoritar i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, duket se favorizon një proces të ngadaltë të integritimit në BE. Poashti, anëtarësimi në BE do të thotë gjithashtu zbatim i shtetit ligjor dhe kjo mund të rrezikojë fuqinë e tij. Qëllimi i tij kryesor nuk është integrimi i Serbisë në BE, por që ai të mbetet lojtar i domosdoshëm për SHBA-të dhe BE-në, të cilat janë të interesuara të dëbojnë Kinën dhe Rusinë nga Ballkani dhe të fusin Serbinë në NATO.

BE-ja dhe SHBA-të duhet të koordinojnë 'shkopinjat dhe karrotat' e tyre dhe të përmirësojnë "saktësinë e tyre të synuar". Shkopinjat duhet të kenë cak interesat e udhëheqësve dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Tani nuk ka dhimbje për udhëheqësit. Duhet të ketë dhimbje. Është e rëndësishme që Presidenti Vuçiç të dijë se ai nuk mund ti ikë marrëveshjes. Ai duhet të kuptojë se humb personalisht nëse pengon marrëveshjen. "Ne po flasim për autokratët në qytete të vogla, jo për gjigandë." Ata nuk kanë nevojë për shumë presion për të ndryshuar kursin e tyre. Nëse interesi kryesor i udhëheqësve është të ruajnë fuqinë dhe pasurinë e tyre, SHBA-të dhe BE-ja duhet të

targetojnë pikërisht fuqinë dhe pasurinë e tyre: të ngrijnë pasuritë e tyre dhe të bashkëpunëtorëve, të mos i lejojnë ata të lëvizin para, të vendosin në listën e zezë bashkëpunëtorët e tyre, të ndërpresin takimet me Angela Merkel ose Emmanuel Macron, t'i shpallin ata non grata dhe në fund të fundit t'i izolojnë. "Nëse vazhdojmë t'i trajtojmë ata si George Washington dhe Thomas Jefferson, do të kemi të njëjtin problem." Mbi të gjitha, sanksionet janë një mjet i diplomacisë që SHBA-të dhe BE-ja përdorin në pjesë të tjera të botës. "Le t'i zbatojmë ato edhe në Ballkanin Perëndimor." Shumë folës kanë dakord që SHBA-të dhe BE-ja kanë mjetet e mjaftueshme për të zgjidhur këtë konflikt.

SHBA-të dhe BE-ja kanë nevojë që ne ta artikulojmë një qëllim të përbashkët, duke përcaktuar çfarë është e mundur në një periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe hapa konkretë se si të arrijmë deri aty. Për të arritur një strategji të përbashkët, është e nevojshme të ketë edhe normalizim të marrëdhënieve SHBA-BE dhe mobilizim të ekspertizave të tyre.

Pjesëmarrësit

Jennifer Brush, Ish-Ambasadore; Ish-Drejtoreshë, Zyra për Evropën Jugore-Qendrore, Departamenti i Shtetit, SHBA; Ish-Zëvendës-Përfaqësuese Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë

Steven Burg, Kryetar, Bordi i Drejtorëve, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse; Profesor, Universiti Brandeis

Robert Cooper, Ish-këshilltar, Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm

Thomas Countryman, Anëtar, Bordi i Drejtorëve, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse; ish-ndihmës sekretar, Departamenti i Shtetit, SHBA

Greg Delawie, Ish-Ambasador i SHBA-ve në Kosovë

Shpetim Gashi, Zëvendës-Drejtor, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Stephen Heintz, President, Fondi i Vëllezërve Rockefeller

Tracey Jacobson, Ish-Ambasadore i SHBA-ve në Kosovë

Jean-Hubert Lebet, Ish-Ambasador i Zvicrës në Kosovë

Pierre Mirel, Anëtar, Bordi i Drejtorëve, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse; Drejtor i Përgjithshëm Nderi, Komisioni Evropian (dorëzoi një punim por nuk mund të merrte pjesë në diskutim)

Cameron Munter, Ish-Ambasador i SHBA-ve në Serbi

Igor Novakovic, Bashkëpunëtor në Serbi, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Alex Roinishvili Grigorev, Drejtor, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Joachim Ruecker, Ish-Shef i Misionit të OKB-së në Kosovë

Kyle Scott, Ish-Ambasador i SHBA-ve në Serbi

Christoph Spaeti, Zyrtar Programi, Departamenti i Sigurisë Njerëzore, Departamenti Federal i Zvicrës për Punë të Jashtme

Karsten Voigt, Ish Koordinator i Marrëdhënieve Gjermani-Amerikë Veriore, Zyra Gjermane për Punë të Jashtme; Ish-Drejtor, Asambleja Parlamentare e NATO-s

Mia Vukojevic, Drejtoreshë Programi, Ballkani Perëndimor, Fondi i Vëllezërve Rockefeller

Hoyt Yee, Ish-Zëvendës Ndhmës Sekretar, Departamenti i Shtetit, SHBA